

DEKRET
Nr. 404, datë 17.12.2024

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 116/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin ‘Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë’”, ratifikuar me ligjin nr. 57/2015.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 116/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin ‘Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë’”, ratifikuar me ligjin nr. 57/2015.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj